

**Halliburton B.V- Degë e një shoqërie të huaj
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 16

Halliburton BV – Albanian Branch

(Vlerat janë në '000 Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2016
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare	4	12,496
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	82,664
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura		9,036
Të tjera llogari të arkëtueshme		-
Inventari	6	36,771
Te ardhurat e llogaritura	7	21,830
Total Aktive Afatshkurtra	162,798	238,915
Aktivët afatgjata		
Aktive afatgjata materiale	8	124,897
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	9	96,800
Total aktive afatgjata	221,697	243,039
Total Aktive	384,495	481,954
DETYRIMET		
Detyrime afatshkurtra		
Llogari të pagueshme tregtare	10	14,203
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura		491,733
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	11	1,041
Detyrime tatimore	12	3,102
Total Detyrime afatshkurtra	510,079	415,705
Detyrime afatgjata		
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura		-
Total Detyrime afatgjata	-	145,490
Totali i detyrimeve	510,079	561,195
Kapitali aksionar		
Humbje të akumuluar		(79,241)
Humbja e vitit		(46,343)
Total kapitali aksionar	(125,585)	(79,241)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	384,495	481,954

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Halliburton BV – Albanian Branch

(Vlerat janë në '000 Lek)

**Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Shenime	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	13	251,079	235,500
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	14	(29,419)	(3,751)
Të tjera shpenzime	15	(248,976)	(217,502)
Shpenzime të personelit	16	(22,194)	(16,535)
1) Paga dhe shpërblime		(20,431)	(15,713)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(1,763)	(822)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(39,230)	(23,955)
Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto	17	42,396	(8,444)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		42,396	(8,444)
Humbja para tatimit		(46,343)	(34,688)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	-
Humbja e vitit		(46,343)	(34,688)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Halliburton BV – Albanian Branch

(Vlerat janë në '000 Lek)

**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Humbjet e akumuluar	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	(44,553)	(44,553)
Humbja e vitit	(34,688)	(34,688)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	(79,241)	(79,241)
Humbja e vitit	(46,343)	(46,343)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	(125,584)	(125,584)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare. Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 u aprovuan dhe u nënshkruan si më poshtë:


Dario Modesto Vitale
Përfaqësues ligjor i Degës




EY Albania shpk
Hartues i Pasqyrave



Halliburton BV – Albanian Branch

(Vlerat janë '000 në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Humbja e vitit	(46,343)	(34,688)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare: Vlera kontabël e asetëve të dala jashtë përdorimi	(3)	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	39,230	23,955
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Rënie / (rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	88,146	(105,170)
Rritje në inventarë	(4,020)	(122,416)
Rritje në detyrimet e pagueshme	94,377	399,148
Mjete monetare neto nga aktiviteti i shfrytëzimit	171,387	160,829
Fluksi i Mjeteve Monetare nga aktiviteti i investimit		
Të ardhura / (Pagesa) për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	1,214	(189,295)
Mjete monetare neto nga / (përdorur në) aktivitetin e investimit	1,214	(189,295)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga aktiviteti i financimit		
(Pagesa) / Të ardhura nga kompania Mëmë	(19,101)	11,540
(Pagesa) / Të ardhura nga hua të arkëtuara	(145,490)	17,927
Mjete monetare neto nga / (përdorur në) aktivitetin e financimit	(164,591)	29,466
Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	8,010	1,000
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	4,487	3,487
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	12,496	4,487
4		

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Halliburton BV – Albanian Branch
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në '000 Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

Dega ne Shqipëri e Halliburton B.V. (më poshtë si Dega), është Dega në Shqipëri e shoqërisë së huaj Halliburton B.V.

Dega është regjistruar më datë 24 Shtator 2013, dhe është pajisur me NIPT L32124010K me seli ne Rr. "Ibrahim Rugova", Sky Tower Business Center, Kati 10, zyra 103, Tiranë.

Veprimtaria e Degës është: a) Ofrimi i shërbimeve b) Shperndarja e mallrave ne industrine e kerkimit te naftes dhe te gazit c) Importi dhe eksporti i lendeve plasese per perdorim civil ne Republiken e Shqiperise.

Numri i punonjësve të Degës më 31 Dhjetor 2017 është 12 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi në fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Degës përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Dega do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Degës.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Degës të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga paaftësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve.

Halliburton BV – Albanian Branch Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në '000 Lek)

Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Dega vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste Dega provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
Euro/ALL	132.95	135.23
USD/ ALL	111.10	128.17

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Dega bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Dega transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë

risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Dega angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Degës skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Dega nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Halliburton BV – Albanian Branch Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në '000 Lek)

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuara, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Dega do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktiviteti afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jeta e dobishme e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma vjetore e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlerë e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25 %
Mjete transporti	Vlerë e mbetur	20 %
Instrumenta dhe vegla pune	Vlerë e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Halliburton BV – Albanian Branch Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në '000 Lek)

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për diferencat në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Dega paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i Degës dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Dega ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivitet dhe Detyrimet e Kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Halliburton BV – Albanian Branch
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në '000 Lek)

4. Mjete monetare

Mjetet monetare detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Llogari rrjedhese Raiffeisen Bank Lek	3,269	1,800
Llogari rrjedhese Raiffeisen Bank Euro	9,227	2,687
	<u>12,496</u>	<u>4,487</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Klientë	70,644	103,073
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	9,036	5,071
Parapagime	12,021	160
	<u>91,701</u>	<u>108,304</u>

6. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Inventari	36,771	32,752
	<u>36,771</u>	<u>32,752</u>

7. Te ardhura te perlogaritura

Të ardhurat e llogaritura detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Të ardhura të llogaritura	21,830	90,648
	<u>21,830</u>	<u>90,648</u>

Halliburton BV – Albanian Branch
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në '000 Lek)

8. Aktive Afatgjata Materiale

	Makineri dhe pajisje	Total
Kosto		
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	-	-
Shtesa	189,295	189,295
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-
Gjëndja më 31 Dhjetor 2016	189,295	189,295
Shtesa	1,699	1,699
Nxjerrje jashtë përdorimit	(6,993)	(6,993)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2017	184,001	184,001
Amortizimi i akumuluar		
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	-	-
Amortizimi i vitit	23,955	23,955
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-
Gjëndja më 31 Dhjetor 2016	23,955	23,955
Amortizimi i vitit	39,230	39,230
Nxjerrje jashtë përdorimit	(4,081)	(4,081)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2017	59,104	59,104
Vlera neto kontabël		
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	165,340	165,340
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	124,897	124,897

Halliburton BV – Albanian Branch
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në '000 Lek)

9. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët te lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Të drejta dhe detyrime nga kompania Mëmë	96,800	77,699
	<u>96,800</u>	<u>77,699</u>

10. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Furnitorë	14,203	10,122
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	491,733	324,907
	<u>505,936</u>	<u>335,029</u>

11. Shpenzime të përlogaritura

Të pagueshmet për shpenzime të përlogaritura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Shpenzime të përlogaritura	1,041	80,042
	<u>1,041</u>	<u>80,042</u>

12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	1,600	308
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	511	165
Tatimi mbi vlerën e shtuar	991	-
Tatim ne burim	-	111
Të tjera tatime për tu paguar dhe për tu kthyer	-	50
	<u>3,102</u>	<u>634</u>

13. Të ardhura nga shitja

Të ardhurat nga shitja detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga shitja e shërbimeve	185,792	126,002
Të ardhura nga shitja e materialeve	43,457	18,850
Të ardhura të përlogaritura	21,830	90,648
	<u>251,079</u>	<u>235,500</u>

Halliburton BV – Albanian Branch
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në '000 Lek)

14. Materiale të para dhe të konsumueshme

Materiale të para dhe të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016</u>
Kosto te shitjeve	(29,419)	(3,751)
	<u>(29,419)</u>	<u>(3,751)</u>

15. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016</u>
Shpenzime qiraje dhe personeli	(101,688)	(14,982)
Shpenzime të tjera	(98,739)	(152,692)
Shpenzime transporti	(19,835)	(10,314)
Shërbime konsulencash	(18,421)	(34,111)
Shërbime doganore	(5,782)	(2,675)
Tatime dhe taksa	(3,186)	(1,178)
Shpenzime të lidhura me automjetet	(767)	(344)
Penalite dhe te tjera te panjohura	(381)	(1,078)
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	(121)	-
Shpenzime sigurimi	(55)	(69)
Shpenzime per pritje percjellje	-	(58)
	<u>(248,975)</u>	<u>(217,502)</u>

16. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016</u>
Shpenzime për paga	(20,431)	(15,713)
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	(1,763)	(822)
	<u>(22,194)</u>	<u>(16,535)</u>

17. Të ardhura/shpenzime financiare, neto

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të Degës. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

Halliburton BV – Albanian Branch
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në '000 Lek)

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Fitime nga kurset e kembimit	56,917	5
Humbje nga kurset e kembimit	(14,127)	(8,201)
Sherbime Bankare	(394)	(248)
	42,396	(8,444)

18. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Humbja kontabël per vitin	(46,343)	(34,688)
Shpenzime te panjohura	23,138	25,103
Humbja (përfshirë shpenzimet e panjohura)	(23,205)	(9,585)
Humbje fiskale e mbartur	(77,165)	(44,553)
Humbja fiskale totale	(100,370)	(54,138)
Tatim fitimi @15%	-	-
	(46,343)	(34,688)

19. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Dega mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të Degës ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 Dhjetor 2017, Dega nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

20. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

